



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2020:099359
Datë: 16.02.2021
Numri i dokumentit: 01514812

C.nr.149/2020

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nehat Qelaj si dhe me Zyrtarin e Lartë për Bashkëpunim Profesional Visar Morina, në çështjen juridike të paditësit A. K. nga fshati M., Komuna e Malishevës, të cilin e ka përfaqësuar Av.H. K. nga Malisheva, ndaj të paditurës K.e M.-D. e A., të cilin e ka përfaqësuar Avokati Publik Komunal M. S., sipas bazës juridike kompensim i Pagave Jubilarë, pas mbajtjes së seancës kryesore me datë 03.02.2021, tani me datë 16.02.2021 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A. K. nga fshati M., Komuna e Malishevës.
- II. DETYROHET** e paditura K. e M.- D. e A. që paditësit A. K. nga fshati M., Komuna e M., në emër të një page jubilarë të përlllogaritur prej 150% të pagës neto t'ia paguaj shumën prej 839.32 euro me kamat ligjore prej 8% nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi datë 16.02.2021, e deri në përmbushjen definitive të detyrimit në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.
- III. DETYROHET** e paditura që paditësit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 104 euro në emër të parashtrimit të padisë, shumën prej 21.00 euro në emër të taksës gjyqësore dhe shumën nga prej 135.00 euro në emër të përfaqësimit nga avokati për dy seanca.

A R S Y E T I M

Paditësi A. K. nga fshati M., Komuna e Malishevës përmes të autorizuarit të tij Av. H. K. nga M., në këtë gjykatë me dt. 21.07.2020 ka parashtruar padi ndaj të paditurës K. e M.-D. e A. lidhur me kompensimin e pagave jubilarë pasi që sipas padisë paditësi deri me datë 05.03.2020 përkatësisht deri me ndërprerjen e marrëdhënies së punës ishte mësimdhënës i Gjuhës dhe letërsisë shqipe në SHFMU "B. G." M., mbi 40 vite përvojë punë pa ndërprerë. Bazuar në nenin 35 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të vitit 2017 thuhet se mësimdhënësit / anëtare të SBASHK-ut për vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësit dhe atë për 10 vite përvojë punë në vlerë prej 50% te pagës baze, për 20 vite 75%, për 30 vite në vlerën e një page baze, ndërsa për 40 vite në vlerë prej 150% të pagës bazë.

I autorizuari i paditësit gjatë seancës ndër tjera deklaroi se mbes në tersi pran kërkesëpadisë, për çka nga gjykata kërkojmë që e njëjta të aprovohet në tersi pasi që është mbështetur përkatësisht kjo e drejt ti njihet paditësit nga kontrata kolektive e vitit 2017 andaj duke marrur për bazë edhe përvojën e punës të paditësi tek e paditura konsiderojmë së kërkesëpadia është e bazuar. Ndërsa pas deklarimeve të përfaqësuesit të paditurës i cili e pranon pjesën e kërkesë padisë sa i përket pagës jubilarë prej 150 % e tërhoqi pjesën e kërkesë padisë lidhur me pagat jubilarë për 50%, 75% dhe 100 % për 30 vite paraprake ndërsa tani e precizon duke kërkuar nga gjykata për 40 vite përvojë punë paditësit ti pranohen 150 % të pagave. Po ashtu në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësit deklaroi se nga administrimi i provave u vërtetua se paditësi ka qenë mësimdhënës dhe e punësuar tek e paditura, dhe me dt.05.03.2020 për shkak të moshës 65 vjeçare të njëjtit i ndërpritet marrëdhënia e punës si pasoje e pensionimit. Meqenëse se paditësi ka pasur përvojë të punës mbi 40 vite, edhe njëherë i propozojmë gjykatës që të aprovoje kërkesëpadinë e precizuar në këtë seance duke e detyruar të paditurin që paditësit ti kompensohet 150% e pagës jubilarë për 40 vite përvojë pune, si dhe ti kompensoje shpenzimet e procedurës të precizuara dhe atë për parashtrimin e padisë shumen prej 104.00 euro, për taka gjyqësore shumen prej 21.00euro, për përfaqësim nga avokati për dy seanca 135.00 euro, e të gjitha këto prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë e këtij aktgjykimi. Ndërsa pas deklarimeve të paditësit i cili e pranon pjesën e kërkesëpadisë sa i përket pagës jubilarë 150% e tërhoqi pjesën e kërkesëpadisë lidhur me pagat jubilarë 50%, 75%, dhe 100% për 30 vite paraprake, ndërsa tani kërkesëpadinë e precizojë duke kërkuar nga gjykata për 40 vite përvojë pune paditësit të pranohen 150% të pagave duke e detyruar të paditurën që të paguaj këtë vlerë si dhe shpenzimet e procedurës për padi, tekta gjyqësorë dhe një seance për përfaqësim sipas tarifës së odes së avokateve.

I autorizuari i të paditurës deklaroi se e kontestojmë pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit dhe atë sa i përket llogaritjeve të provoj së punën për 10 vite, 20 vite, 30 vite, deri në 40 vite pasi që sipas kontratave kolektive neni 35 shumë qartë e përcakton se 40 vite përvojë pune i takon 150% të pagës baze prandaj nuk e kontestojmë kërkesëpadinë në këtë drejtim përkatësisht 150% të pagës baze për 40 vite përvojë punës. Po ashtu në fjalën përfundimtare deklaroi se mbes si ne deklarimet e kësaj seance.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar, ndërsa shpenzimet e precizuara nga i autorizuari i paditësit i ka kontestuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata me propozimin dhe pëlqimin e palëve pas përfundimit të seancës përgatitore menjëherë hapi shqyrtimin kryesor duke bërë administrimin e provave dhe atë; Vendimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës nr. ... të datës 19.02.2020, kontrata e punës së paditësit nr. ... të datës 06.10.2015, Listën e Pagave datës 26.03.2019 deri 24.12.2019.

Pas vlerësimit të të gjitha provave veç dhe veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësit është bazuar dhe si të tillë e aprovoj në tërësi.

Nuk ishte kontestuese fakti se paditësi ishte në marrëdhënie punë në cilësinë e mësimdhënësit në SHFMU "B. G." në M. dhe se i ka përfunduar punësimi me datën 05.03.2020, për shkak të pensionimit e po ashtu nuk ishte kontestuese fakti se përvoja e tij e punës ishte mbi 40 vite si dhe paga e tij e fundit bruto para pensionimit tek e paditura ishte 559.55 euro kjo gjendje faktike gjen mbështetje në vendimin nr.... dt.19.02.2020, kontratën e punës si dhe Listën e Pagave të cilat prova janë prezantuar nga i autorizuari i paditësit dhe nuk kanë qenë të kontestuar nga i autorizuari i të paditurës.

Në bazë të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive në Kosovë, e cila ishte në fuqi në periudhën e pensionimit të paditësit e cila është shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr.38 e datës 14/06/2014, e cila është nënshkruar nga autoritetet kompetente dhe në nenin 82 të kësaj marrëveshje kanë paraparë se e njëjta hynë në fuqi me datën 01/01/2015 ndërsa në nenin 2 par.1 kanë paraparë se këto dispozita zbatohen për palët kontraktuese në nivel privat, publik dhe shtetëror (në nivel të përgjithshëm, në nivel të degëve dhe në nivel ndërmarrjeje) ndërsa në nenin 52 dhe 53 po ashtu kanë paraparë shpërblimin jubilar dhe kompensimin në rast pensioni.

Në rastin konkret duke marrë për bazë se paditësi ka dal në pension në vitin 2020, Gjykata vendosi që paditësit t'ia njoh në një pagë jubilarë duke u bazuar në nenin 35 par.8 pika 8.4 dhe par.8 pika 8.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit e lidhur me datë 18.04.2017 në mes të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, (MASHT) dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, 9SBASHK), ku në nenin 35 paragrafi 8 nën paragrafi 8.4 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë ndër të tjera përcaktohet se **“Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilarë nga punëdhënësi i fundit në vlerë për 40 vite të përvojës së punës në vlerë prej 150 % të një page bazë**, për çka në rastin konkret paditësi kishte mbi 40 vite përvojë të punës dhe gjykata me zbatimin e dispozitave të lartpërmendura vendosi aprovimin e tërësishëm të kërkesëpadisë e precizuar të paditësit në emër të një page jubilarë prej 150% të pagës së fundit neto përkatësisht shumë prej 839.32 euro.

Gjykata vlerëson se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive në Kosovë dhe Kontratës Kolektive e Arsimit Parauniversitar datës 18.04.2017 janë të zbatueshme në tërë territorin e Republikës së Kosovës që nënkupton se këto dokumente kontraktuale prodhojnë efekt juridik ndaj ndërgjyqësve.

Gjykata vendosi që paditësi t'ia njoh të drejtën për një paga jubilarë bruto në vlerën prej 150% përkatësisht shumë 839.32 euro, duke u bazuar në nenin 52 dhe 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive në Kosovë dhe nenin 35 par.8 pika 8.4 dhe par.8 pika 8.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit e lidhur me datë 18.04.2017 sepse paditësi ka përvojë 40 vite dhe paga e tij e fundit bruto para pensionit ishte 559.55 €.

Gjykata vlerëson se e paditura nuk ka prezantuar kurrfarë prove relevante, me çka do të argumentonte të kundërtën nga ajo çka pretendon paditësi përveç kundërshtimeve paraqitura më lart, andaj gjykata vlerëson se e njëjta ka hyrë në raport të detyrimeve me paditësin, në të cilin raport paditësi e ka cilësinë e kreditorit, kurse e paditura e ka cilësinë e debitorit.

Sipas nenit 8 parag.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve **“Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre”**, ndërsa në dispozitat e nenit 245 parag.1 të LDM-së, ka paraparë se **“Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkoj përmbushjen e detyrimit e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë”**, andaj meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se e paditura e ka obligim që t'ia kompensojë paditësit për 40 vite të përvojës së punës në vlerën prej 150% të një pagës bazë ashtu siç është përcaktuar me lartë, prandaj gjykata me zbatimin e dispozitave të lartë cituar, në këtë gjendje të vërtetuar faktike e detyroj të paditurën që paditësit t'ia paguaj shumë si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është bazuar në nenin 452 parag.1 të Ligjit për Procedurës Kontestimore sipas së cilës paditësit i pranohen shpenzimet në shumë prej 104 euro në emër të parashtrimit të padisë, shumë prej 21.00 euro në emër të taksës gjyqësore dhe në emër të përfaqësimit nga avokati shumë nga 135.00 euro për dy seanca gjyqësore.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-DEGA NË MAALISHEVË
Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.194/2020 e datës 16.02.2021

GJYQTARI
Nehat Qelaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit e Kosovës në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme.